

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7950
E mërkurë, 11 dhjetor 2024
Çmimi 0.50

Këshillit të BE-së
i kërkohet ta shqyrtojë
aplikimin e Kosovës
për anëtarësim | FAQE 9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

HOVENIERI: KA AKTORË TË HUAJ QË DUAN TA MINOJNË DEMOKRACINË E KOSOVËS DUKE SHFRYTËZUAR PËRÇARJET ETNIKE | FAQE 4-5



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë të martën se në Kosovë ka aktorë të huaj keqdashës

aktivë që duan ta minojnë demokracinë e Kosovës duke i shfrytëzuar përçarjet etnike. Ai ka theksuar se dezinformimi mund të ketë

pasoja të drejtpërdrejta gjithmonë, veçanërisht gjatë periudhës zgjedhore, në të cilën Kosova ndodhet aktualisht

AKTUALE



AMBASADORJA AMERIKANE PARALAJMËRON SËRISH ZGJERIMIN E LISTËS SË ZEZË NË MAQEDONINË E VERIUT | F. 2

SVEÇLA: PJESËTARË TË LISTËS SERBE, TË PËRFSHIRË NË TRAZIRA TË VAZHDUESHME NË VERI | F. 5

FSK-ja DHE AJOVA, PLAN TË PËRBASHKËT PËR VITET 2025-2027 | F. 7

EKONOMI



EKONOMIA KREATIVE NË KOSOVË, KURTI: KY ËSHTË SEKTORI I NËNTË MË I MADH PËR NGA PUNËSIMI | F. 8

RRITET NUMRI I TURISTËVE NË KOSOVË, PRIN REGJIONI I PEJËS | F. 8

SPORT



SOT DY NDESHJET KTHYSE NË ÇEREKFINALE TË KUPËS | F. 10

MONITORIMI ELEKTRONIK DO TA LUFTOJË DHUNËN NË FAMILJE | F. 5



KE-ja: RRRITET MBI 100 PËR QIND NUMRI I KËRKESAVE TË PABAZA PËR AZIL NGA KOSOVA | F. 5



RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ambasadorja amerikane paralajmëron sërish zgjerimin e listës së zezë në Maqedoninë e Veriut

SHKUP, 10 DHJETOR - Ambasadorja amerikane në Shkup, Angela Aggeler, ka paralajmëruar për herë të dytë brenda javësh se Uashingtoni po shqyrton mundësi të reja për të vendosur sanksione ndaj personave të tjerë të dyshuar për krim dhe korrupsion në Maqedoninë e Veriut. Aggeler e bëri këtë paralajmërim të martën, një ditë pasi Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) njoftoi se ka vendosur ish-zëvendëskryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, dhe gjykatësin e Gjykatës së Apelit, Enver Bexheti, në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara. “Ka një sërë sanksionesh në dispozicion nga qeveria amerikane, siç e dini. Ka sanksione të Thesarit. Ka sanksione të zgjeruara të mundshme për anëtarët e tjerë

të familjes së atyre që janë emëruar. Pra, në këtë pikë, të gjitha ato shqyrtime janë ende në proces”, tha Aggeler në një konferencë për shtyp në Shkup.

Ajo nuk përmendi emra ose afate kohore, por shtoi se ShBA-ja do të vazhdojë t’i mbajë përgjegjës “aktorët e korrumpuar”. “[Futja në listën e zezë] e individëve që janë përfshirë në korrupsion kriminal është një proces që vazhdon. Ka një listë shumë dinamike, në kuptimin që ajo vazhdimisht shtohet, dhe provat shqyrtohen shumë me kujdes në Uashington”, theksoi Aggeler.

Grubi, i cili ishte zëvendëskryeministër i Maqedonisë së Veriut nga radhët e Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) gjatë mandatit të kaluar 2020-2024, dhe gjykatësi Bexheti, sipas



DASH-it, “janë përfshirë në korrupsion të madh duke pranuar ryshfet për t’i minuar proceset gjyqësore të lidhura me dënimin penal të Sasho Mijalkovit, ish-drejtorit të shërbimit sekret”.

Aggeler, në përgjigje të pyetjeve nga gazetarët, nuk dha hollësi specifike për rolin e Grubit në

këtë çështjen e Mijalkovit, por theksoi se provat shqyrtohen me kujdes të veçantë para se të publikohen.

Nga ana tjetër, zëvendëskryeministri i parë i Maqedonisë së Veriut, Izet Mexhiti, i cili është pjesë e koalicionit shqiptar VLEN në Qeveri, vlerësoi se vendimi i

DASH-it për vendosjen e Artan Grubit në listën e zezë është “konfirmim për angazhimet e drejta të koalicionit”.

Mexhiti i bëri thirrje anëtarësisë së BDI-së që ta braktisë, siç e quajti ai, “anijen që po fundoset”.

Ndërkohë, partia maqedonase VMRO-DPMNE, e kryeministrit Hristijan Mickoski, e quajti sanksionimin e Grubit dhe Bexhetit “një turp të madh për shtetin”.

Në listën e zezë amerikane janë edhe ish-kryeministri maqedonas Nikolla Gruevski, ish-zëvendëskryeministri Koço Angjushev, kryetari i komunës së Strugës, Ramiz Merko, biznesmeni Orce Kamçev, kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare Menduh Thaçi, ish-deputeti Xhevat Ademi, ish-ministri i Punëve të Brendshme Lube Boshkovski dhe të tjerë.

Shpërthime të fuqishme në Damask teksa Izraeli sulmon qendrat ushtarake

DAMASK, 10 DHJETOR - Shpërthime të fuqishme janë dëgjuar të martën në Damask, teksa ka raportime se Izraeli është duke goditur në mënyrë sistematike qendra të ushtrisë siriane, pas rrëzimit të regjimit brutal të Bashar al-Assadit.

Vëzhguesi Sirian për të Drejtat e Njeriut, organizatë me bazë në Londër, ka thënë përmes një deklarate se Izraeli “ka shkatërruar shumicën e qendrave të rëndësishme ushtarake në Siri”, derisa trupat izraelite janë pozicionuar në zonën neutrale afër Rafshnaltës së Golanit, të aneksuar nga Izraeli.

Qeveria izraelite e ka arsyetuar pozicionimin ushtarak, duke përmendur “arsye të sigurisë”.

Vëzhguesi Sirian ka thënë se Izraeli i ka kryer mbi 250 sulme ajrore në territorin sirian në dy



ditët e fundit, me qëllim të shkatërrimit të kapaciteteve ushtarake të Sirisë. “Izraeli i ka shkatërruar qendrat më të rëndësishme ushtarake në Siri, përfshirë aeroportet siriane dhe magazinat e tyre, radarët, stacionet e sinjaleve ushtarake, dhe shumë depo të armëve dhe municionit”, sipas organizatës britanike.

Këto raportime kanë ardhur teksa kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ka thënë se Izraeli është duke “transformuar fytyrën e Lindjes së Mesme” dhe po mposht armiqët “hap pas hapi”. Uashingtoni ka thënë, po ashtu, se i ka kryer rreth 75 sulme ajrore kundër militantëve të grupit ekstremist Shteti Islamik

(IS), të cilët kanë ende prani në Siri, me qëllim që grupit t’i pamundësohet nisja e ndonjë trazire pas rrëzimit të Assadit. Ndërkohë, udhëheqësit e rinj de facto në Damask kanë nisur përpjekjet për ta stabilizuar situatën, teksa bota po shikon me vëmendje zhvillimet atje.

Rebelët e udhëhequr nga grupit militant Hayat Tahrir al-Sham (HTS) kanë thënë më 9 janar se do të përdorin të drejtën e amnitisë për të gjithë personelin ushtarak të rekrutuar gjatë regjimit të Assadit.

Bashar al-Assad është ngjitur në pushtet më vitin 2000, pas vdekjes së babait të tij, Hafez al-Assad, i cili ka qenë në krye të shtetit që prej vitit 1970.

Kryeministri sirian Muhammad Ghazi al-Jalali, i cili ka qëndruar në pozitën e tij dhe është zotuar

se do të bashkëpunojë me liderët e rinj, ka thënë se shumica e ministrave të kabinetit janë ende në pozitë e tyre. Jalali është thënë të jetë takuar edhe me liderët e rinj. “Jemi duke punuar që periudha e tranzicionit të jetë e shpejtë dhe të shkojë mirë”, ka thënë ai në disa komente për televizionin “Sky News Arabia”. HTS është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Në vitet e fundit grupi i ka prishur lidhjet që ka pasur me Al-Kaidën dhe ka mëtuar ta shpërfaqë veten si alternativë pragmatike përballë qeverisë siriane. Megjithatë, disa grupe për të drejtat e njeriut dhe qeveritë perëndimore kanë pikëpyetje për lidhjet e këtij grupi me organizatat e tjera terroriste.

Zelensky i hapur për praninë e trupave të huaja në Ukrainë

KIEV, 10 DHJETOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka thënë të hënën se do ta konsiderojë vendosjen e përkohshme të forcave të huaja ushtarake në tokën ukrainase derisa vendi të bëhet anëtar i NATO-s, si mënyrë për ta siguruar vendin e tij si pjesë e marrëveshjes për paqe me Rusinë.

Duke folur më 9 dhjetor në një konferencë të përbashkët në Kiev me liderin opozitar të Gjermanisë, Freidrich Merz, Zelensky tha se për të qenë

Ukraina e sigurt, nuk nevojitet vetëm anëtarësimi në NATO, por edhe në Bashkimin Evropian gjithashtu, në mënyrë që të frenohet agresioni nga Moska. “Një kontingjent i forcave ushtarake nga një vend apo tjetër mund të qëndrojnë në Ukrainë derisa ajo të bëhet anëtare e NATO-s”, tha Zelensky, duke lënë të nënkuptohet se Kiev është i hapur për gjetjen e një zgjidhjeje diplomatike për luftën ruse gati tri vjet të gjatë.



Deklarata e Zelenskyt u bënë jehonë diskutimeve të mëparshme këtë vit, kur presidenti i Francës, Emmanuel Macron, bëri thirrje për vendosjen e

forcave evropiane në Ukrainë.

Derisa Zelensky pranoi se konsultimet mbi këtë çështje janë duke vazhduar, ai theksoi se dhënia e garancive absolute të sigurisë për Ukrainën është e rëndësishme.

“Ukraina dëshiron më shumë se kushdo tjetër që kjo luftë të përfundojë. Nuk ka dyshim, një zgjidhje diplomatike do të shpëtonte më shumë jetë. Ne e kërkojmë këtë”, tha ai. “Nëse ka pauzë derisa Ukraina nuk është në NATO, edhe nëse

kemi ftesën dhe nuk jemi në NATO, dhe do të ketë pauzë, atëherë kush na garanton siguri neve?” shtoi Zelensky. Zelensky tha më vonë në “Telegram” se planifikon t’i telefonojë presidentit amerikan Joe Biden për të biseduar për çështjen e anëtarësimit të Ukrainës në NATO.

Që nga fillimi i pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia në shkurt 2022, Kiev ka bërë thirrje për zotime më të mëdha të sigurisë nga aleatët perëndimorë.

BE-ja konfirmon se më 17 dhjetor zhvillohet raundi i ri i dialogut Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Bashkimi Evropian ka konfirmuar të martën se takimi i radhës në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, në nivel kryenegociatorësh, do të zhvillohet më 17 dhjetor në Bruksel, dhe se të dyja palët kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në këtë takim.

Zëdhënësja e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Anitta Hipper, ka thënë se në këtë takim do të shqyrtohen një varg çështjesh, përfshirë edhe zbatimin e Marrëveshjes Drejt Normalizimit të Marrëdhënieve.

Takimi i fundit në nivel kryenegociatorësh është

zhvilluar më 23 tetor në Bruksel.

Kosova përfaqësohet nga zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, ndërsa Serbia nga drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković.

Sipas burimeve diplomatike të Radios Evropa e Lirë, i dërguari evropian për dialogun, Miroslav Lajçak, u ka raportuar vendeve anëtare për gjendjen e dialogut dhe ka thënë se palët kanë mungesë të qartë të gatishmërisë për të bërë ndonjë progres në zbatimin e Marrëveshjes për Normalizim.

Palët kanë arritur pajtueshmëri



për këtë marrëveshje në shkurt të vitit të kaluar në Bruksel, ndërsa për një aneks zbatimin në Ohër të Maqedonisë së Veriut, një muaj më vonë. Dy vendet nuk kanë bërë hapa drejt zbatimit të paktit dhe për

këtë fajësojnë njëra-tjetrën.

Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Kaja Kallas, ka shprehur gatishmëri të angazhohet aktivisht në procesin e dialogut.

Mandati i Lajçakut, i vazhduar disa herë, do të përfundojë në fund të muajit janar të vitit tjetër.

Ka pritur që kryediplomatja Kallas, në bashkëpunim me vendet anëtare, të vendosë lidhur me vazhdimin e dialogut, përfshirë edhe rreth asaj se a do të ketë pasardhës të Lajçakut në atë postë, dhe kush do të jetë ai.

Serbia nuk e njeht pavarësinë e Kosovës të shpallur më 2008.

Dy vendet që dialogojnë në Bruksel me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian qysh prej vitit 2011, kanë arritur disa marrëveshje, por jo të gjitha janë zbatuar.

ShBA-ja e fut në listën e zezë Artan Grubin

SHKUP, 10 DHJETOR - Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) njoftoi të hënën se i ka futur në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara ish-zëvendëskryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, si dhe gjykatësin e Gjykatës së Apelit, Enver Behxheti, për shkak të përfshirjes në "korrupsion të madh".

Në një njoftim për medie, DASH-i tha se Grubi dhe Behxheti "janë përfshirë në korrupsion të madh duke pranuar ryshfet për t'i minuar proceset gjyqësore të lidhura me dënimin penal të Sasho Mijalkovit, ish-drejtorit të shërbimit sekret".

Në listën e zezë janë futur edhe anëtarët e familjes së ngushtë të Grubit, i cili ishte zëvendëskryeministër i Maqedonisë së Veriut nga radhët e Bashkimit Demokratik për Integrim gjatë mandatit të kaluar 2020-2024.

Në një reagim në "Facebook" të hënën vonë, Grubi tha se u njoftua në medie për



vendimin e DASH-it ndaj tij, dhe e mohoi se ka qenë i përfshirë në korrupsion. "Si një person që jetën time publike ua kam kushtuar mbrojtjes së vlerave demokratike perëndimore

dhe që gjithmonë kam punuar me përkushtim për anëtarësimin e vendit në NATO dhe Bashkimin Evropian, ky vendim më drejtpërdrejt dhe personalisht", shkroi Grubi.

Mijalkovi është gjithashtu në listën e zezë të ShBA-së që nga viti 2022.

Vendimi i DASH-it për Grubin dhe Behxetin muaj pasi ambasadorja amerikane në Shkup, Angela Ageler, paralajmëroi më 21 nëntor për zgjerimin e listës së zezë edhe me persona të tjetër të dyshuar për krim dhe korrupsion në Maqedoninë e Veriut.

Ndërkohë, Aggeler tha se vendimi i 9 dhjetorit i DASH-it për Grubin dhe Behxetin "është dëshmi se ndërhyrja politike në gjyqësor nuk mund dhe nuk do të tolerohet". "Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë t'i [fusin në listën e zezë] ata të cilët përfshihen në korrupsion të madh, i cili i minon institucionet demokratike dhe prish besimin publik. Askush nuk është mbi ligjin, ndërsa llogaridhënia është jetike për të përparuar", tha Aggeler.

Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) ka dalë me reagim, pasi Artan Grubi u

vendos në "listën e zezë" nga ShBA-ja.

"Bashkimi Demokratik për Integrim respekton vendimin e Departamentit të Shtetit të ShBA-së. Si parti, mbetemi të përkushtuar ndaj bashkëpunimit strategjik me Shtetet e Bashkuara dhe ndaj forcimit të vlerave demokratike dhe transparencës", është thënë në reagimin e BDI-së.

BDI në një reagim të shkurtër për medie ka bërë me dije se respekton vendimin e Departamentit Amerikan të Shtetit (BDI) dhe se mbetet e përkushtuar për bashkëpunim.

Në listën e zezë amerikane janë edhe ish-kryeministri maqedonas Nikolla Gruevski, ish-zëvendëskryeministri Koço Angjushev, kryetari i komunës së Strugës, Ramiz Merko, biznesmeni Orce Kamçev, kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare, Menduh Thaçi, ish-deputeti Xhevat Ademi, ish-ministri i Punëve të Brendshme Lube Boshkovski dhe të tjerë.

ShBA-ja i jep çmim kreut të SPAK-ut për luftën kundër korrupsionit

TIRANË, 10 DHJETOR - Drejtuesi i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK), Altin Dumani, është nderuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit si kampion në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, teksa i dorëzoi çmimin Dumanit, e vlerësoi SPAK-un si institucionin më të besueshëm në Shqipëri. "Kryeprokurori i Posaçëm i Shqipërisë, Altin Dumani, drejton një agjenci të re kombëtare, që ndjek penalisht zyrtarë të lartë dhe drejtues të krimit të organizuar. Sot është

institucioni publik më i besuar në Shqipëri", tha Blinkeni.

Dumani ishte mes 10 kampionëve kundër korrupsionit nga e gjithë bota që u nderuan të hënën nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Kemi vendosur sistemin non-grata, për njerëzit problematikë, për ata që kanë bërë korrupsion. Dhe, puna që kanë bërë këta njerëz është e jashtëzakonshme se ka dhënë rezultate të jashtëzakonshme, sepse kanë dhënë ndryshimin e perceptimit", u shpreh Blinkeni gjatë ceremonisë.

Ambasada e ShBA-së në Tiranë e përgëzoi kreun e

SPAK-ut për vlerësimin me Çmimin për Kampionët Kundër Korrupsionit për vitin 2024. "Ky çmim nderon vendosmërinë, guximin dhe integritetin tuaj të palëkundur në ndjekjen e drejtësisë në emër të popullit shqiptar. Puna juaj frymëzon të gjithë ata që besojnë në fuqinë e së vërtetës dhe llogaridhënies. Ambasada e ShBA-së do të vazhdojë të punojë me ju, me SPAK-un, dhe me të gjitha institucionet e drejtësisë për ta bërë realitet barazinë përpara ligjit për të gjithë qytetarët e Shqipërisë", theksoi Ambasada Amerikane në një postim në rrjetet sociale.



Altin Dumani mori drejtimin e SPAK-ut dy vjet më parë, ndërsa institucioni u ngrit në dhjetor të vitit 2019, pas ndryshimeve kushtetuese që u votuan në vitin 2016.

Para gjyqit kanë dalë disa ish-zyrtarë, ish-ministra e

deputetë dhe ata tashmë po vuajnë dënimin. Ndërsa të tjerë janë në procese gjyqësore, mes tyre edhe ish-presidenti Ilir Meta, ish-kryeministri Sali Berisha dhe ish-zëvendëskryeministri Arben Ahmetaj.



Hovenieri: Ka aktorë të huaj që duan ta minojnë demokracinë e Kosovës duke shfrytëzuar përçarjet etnike

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë të martën se në Kosovë ka aktorë të huaj keqdashës aktivë që duan ta minojnë demokracinë e Kosovës duke i shfrytëzuar përçarjet etnike. Ai ka theksuar se dezinformimi mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta gjithmonë, veçanërisht gjatë periudhës zgjedhore, në të cilën Kosova ndodhet aktualisht përpara zgjedhjeve të 9 shkurtit

mbështetje të medieve të pavarura, përfshirë ato që drejtohen nga pakicat. "Dhe, ne jemi shumë të vetëdijshëm për mediet që ofrojnë informacion të paanshëm dhe të saktë. Jemi të vetëdijshëm se ka disa që përpiqen të shfrytëzojnë këtë pretendim për të bërë diçka krejtësisht tjetër, për të dhënë një mesazh që synon qëllime shumë, shumë të ndryshme nga informimi i komunitetit. Kjo duhet të denoncohet dhe ne duhet t'i mbështesim mediet e pavarura", ka deklaruar Hovenieri.

Ai tha se "puna jonë së bashku është larg përfundimit". "Në fakt, mund të argumentoni se [puna] mbi këtë çështje, sapo ka filluar dhe ne jemi me të vërtetë të gatshëm të angazhohemi me të gjithë ju për të gjetur mënyra të reja për t'ju ndihmuar ta mbron demokracinë tuaj", u shpreh ambasadori amerikan në Prishtinë.

Eva Palatova nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë tha se dezinformimi dhe manipulimi i informacionit janë bërë kërcënime thelbësore jo vetëm për proceset demokratike. "Përpiqjet tona për ta kundërshtuar manipulimin dhe ndërhyrjen e informacionit të huaj nuk kanë të bëjnë vetëm me luftimin e dezinformimit. Ato kanë të bëjnë me mbështetjen e

proceseve për forcimin dhe rindërtimin e besimit në medie, fuqizimin e qytetarëve për të marrë vendime të mbështetura në informacion dhe mbrojtjen e themeleve të demokracisë", tha ajo, duke nënvizuar se këto përpjekje janë kritike, veçanërisht në kontekstin e zgjedhjeve, ku dezinformimi mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në integritetin e proceseve zgjedhore. "Ndërsa presim zgjedhjet e ardhshme në Kosovë, nevojta për veprime të fuqishme - për ta ruajtur integritetin e informacionit - është edhe më kritike. Zgjedhjet janë një kohë kur informacioni luan një rol qendror në formësimin e opinionit publik dhe në drejtimin e vendimmarrjes. Por, kur informacionet mbi të cilat qytetarët mbështeten janë të shtrembëruara, ato dëmtojnë aftësinë e tyre për të bërë zgjedhje të drejtë. Kjo është arsyeja pse ne duhet të jemi syçelë dhe aktivë në luftën kundër dezinformimit gjatë kësaj periudhe", tha ajo. Ajo tha se Bashkimi Evropian në bashkërendim me Institutin Kombëtar Demokratik do të nisë një studim mbi rrëfimet dhe aktorët e dezinformatave gjatë zgjedhjeve të ardhshme në Kosovë, duke u përqendruar në identifikimin e rrëfimeve kryesore të dezinformatave dhe

në shqyrtimin e ndikimit të tyre në opinionin publik dhe proceset zgjedhore.

Një ditë më herët në këtë konferencë është paraqitur studimi i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, ku është thënë se fushatat dezinformuese në vend shpërndahen qëllimshëm për t'i tensionuar marrëdhëniet ndëretnike.

Nga ky studim del që shumica e kosovarëve, pavarësisht prej etnisë, besojnë se dezinformimi po ndikon në marrëdhëniet ndëretnike.

Madje shumica thonë se vetë ata kanë hasur në dezinformata të tilla.

Ramadan Ilazi, drejtor i hulumtimeve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), thotë se këto dezinformata shpërndahen dukshëm më shumë në rastet kur ka tensione në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe - si sulmi i vitit të kaluar në Banjskë apo sulmi në kanalën e Ibër-Lepencit.

Ai beson se rol në shpërndarjen e këtyre dezinformatave kanë shërbimet e medieve ruse, RT dhe Sputnik, në Serbi, që funksionojnë pavarësisht prej sanksioneve të vendosura nga ShBA-ja dhe BE-ja.

Mediet online shihen në mesin e platformave që bëjnë shpërndarjen më të madhe të dezinformatave.

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Jeffrey Hovenier, tha se në Kosovë ka "aktorë të huaj keqdashës aktivë që duan ta minojnë demokracinë e Kosovës duke i shfrytëzuar përçarjet etnike". "Nuk mund të lejojmë që kjo të ndodhë", tha Hovenieri të martën në Prishtinë, në një konferencë për integritetin e informacionit DISICON, të organizuar nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) me seli në Uashington. Ai shtoi se dezinformimi mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta gjithmonë, veçanërisht gjatë periudhës zgjedhore, në të cilën Kosova ndodhet aktualisht përpara zgjedhjeve të 9 shkurtit.

Ai ia kujtoi audiencës një bisedë të re me të publikuar në rrjetet sociale disa vjet më parë, e cila përfshinte një bisedë të re me tij dhe kryeministrin Kurti dhe që kishte për "synim të mbillte mosbesim brenda komunitetit serb të Kosovës". "Fatmirësisht, jo shumë njerëz e morën seriozisht. Por, fakti që një aktor shkroi një skenar, përgatiti një skenar, krijoi një regjistrim krejtësisht të dizajnuar për të mbjellë mosbesim dhe shqetësim në komunitetin serb dhe e publikoi atë në rrjetet sociale, është një tregues i këtij problemi", theksoi ambasadori amerikan.

Hovenieri, i cili po përfundon mandatin e tij në Kosovë në fund të dhjetorit dhe po pensionohet, theksoi se ShBA-ja mbetet e përkushtuar ndaj Kosovës si një vend i larmishëm dhe në

KE-ja: Rritet mbi 100 për qind numri i kërkesave të pabaza për azil nga Kosova

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Komisioni Evropian (KE) ka tërhequr vërejtjen se në disa vende anëtare të Bashkimit Evropian ka rritje të madhe të numrit të kërkesave të pabaza për azil nga shtetasit e Kosovës në vitin e parë pas heqjes së regjimit të vizave. Megjithatë, Kosova në përgjithësi vazhdon t'i përmbushë kriteret për liberalizimin e vizave, tha KE-ja në raportin e fundit të saj në kuadër të "mekanizmave për suspendimin e liberalizimit të vizave".

Komisioni Evropian përpilon raporte të tilla për të gjitha vendet që gëzojnë liberalizimin e vizave për të parë nëse ka nevojë të shqyrtohet mundësia e rivendosjes së regjimit të vizave. Kjo është hera e parë që Kosova përfshihet në një raport të tillë prej kur BE-ja i hoqi vizat për qytetarët e Kosovës nga 1 janari i këtij viti. Nga janari deri në korrik të këtij viti mesatarisht mbi 550 kosovarë kanë kërkuar azil në vendet e Evropës çdo muaj. Kjo shifër është dukshëm më e lartë se mesatarja në gjashtë vitet e kaluara. Në raport theksohet se për Kosovën është ende herët të

bëhen konstatime të sakta se çfarë ndikimi ka pasur liberalizimi i vizave, pasi nuk ka të dhënë për tërë vitin. Në raportin e vitit të ardhshëm KE-ja do t'i ketë në dispozicion të dhënat e plota. Megjithëkëtë, në raport thuhet se "disa vende anëtare kanë raportuar rritje domethënëse të kërkesave të pabazuara për azil nga qytetarët e Kosovës që nga fillimi i vitit 2024". "Në shtatë muajt e parë të vitit 2024 janë paraqitur 3 905 kërkesa për azil në vendet e BE-së nga shtetasit e Kosovës, që paraqet rritje prej 108-përqindësh krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm", thuhet në raport. Në këtë raport, Komisioni Evropian kërkon që autoritetet e Kosovës të vendosin mekanizma për shkëmbimin e të dhënave me vendet anëtare për ta vëzhguar rrjedhën e imigrimit të paligjshëm dhe trendët e kërkesave për azil. Kosovës, gjithashtu, i kërkohet ta rifillojë fushatën e brendshme të informimit për të drejtat dhe obligimet gjatë udhëtimit në vendet e Zonës Schengen dhe të bashkëpunojë në mënyrë dypalëshe me vendet që janë



më të goditura nga dukuria e kërkesave të pabaza për azil. Një çështje tjetër që ka kërkuar Komisioni Evropian nga Kosova lidhur me vazhdimin e përmbushjes së kriterëve për liberalizimin e vizave është edhe përshtatja e regjimit të vizave të Kosovës me atë të BE-së. Kjo është

kërkesë e bllokut për të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. BE-ja kërkon që të gjitha vendet e rajonit ta përshtatin tërësisht këtë regjim me atë të bllokut, që do të thotë se për të gjitha shtetet për të cilat kërkon viza BE-ja, duhet të kërkojnë edhe ato.

Kosova tani për tani i ka 16 shtete qytetarët e të cilave kanë nevojë për viza për të udhëtuar për në BE, por mund të vijnë në Kosovë pa viza. Kjo mundësi e udhëtimit pa viza në vendet e rajonit të Ballkanit për BE-në konsiderohet rrezik potencial për imigrim ilegal në vendet e saj anëtare.

Sveçla: Pjesëtarë të Listës Serbe, të përfshirë në trazira të vazhdueshme në veri

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, ka thënë të martën se beteja e vazhdueshme e autoriteteve të Kosovës për shtirje të sovranitetit në pjesën veriore të vendit ka demaskuar aspiratat e Serbisë për territorin e Kosovës, dhe që pjesëtarë të Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë - kanë qenë të përfshirë në trazira të vazhdueshme në veri.

Sveçla nuk ka përmendur ndonjë emër në mënyrë specifike dhe deri më tani autoritetet e drejtësisë nuk kanë ngritur ndonjë aktakuzë ndaj zyrtarëve të lartë të Listës Serbe, ndonëse disa janë ftuar për intervistim për pjesëmarrje në protesta.

Ai ka thënë se mungesa e shtrirjes së plotë të institucioneve vendore në pjesën veriore në të kaluarën ka mundësuar terren plotësisht të lirë për grupet kriminale dhe çdolloj aktiviteti ilegal.

Ministri Sveçla i ka bërë këto deklarata pas prezantimit të një raporti të Institutit për Siguri dhe Reziliencë - PREVENT, për sigurinë në veri, pas sulmeve në Banjskë të Zveçanit vitin e kaluar, dhe në kanalën e Ibër-Lepencit në Zubin Potok në nëntor të këtij viti.

Kosova fajëson Serbinë për këto sulme që i konsideron terroriste, ndërsa Beogradi mohon gjithçka. "Nuk mund të thotë Lista Serbe se nuk ka qenë e



përfshirë në sulmin ndaj pjesëtarëve të KFOR-it, kur asistentë, shoferë, truporë, zyrtarë të Listës Serbe, kanë qenë pjesë aktive e sulmit, janë identifikuar dhe tash një pjesë e tyre janë në arrati".

Në maj të vitit 2023 protestuesit serbë në Zveçan janë përleshur me pjesëtarë të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, duke lënë të plagosur mbi 90 paqeruajtës të misionit, disa të plagosur rëndë.

Sipas ministrit Sveçla, integrimi i strukturave paralele serbe në

institucionet e Kosovës, sipas marrëveshjes së Brukselit, ka mundësuar instalim të strukturave që i kanë raportuar Serbisë dhe presidentit serb, Aleksandar Vuçiq. "Kjo faktohet jo vetëm me dorëheqjen e orkestruar të pjesëtarëve serbë nga Policia e Kosovës dy vjet më parë, të cilët me uniformë policore, me pagë të Policisë së Kosovës, dhe me armë zyrtarë të policisë, u kanë shërbyer politikave destabilizuese të Serbisë".

Ai u është referuar dorëheqjeve

kolektive të pjesëtarëve serbë nga institucionet e Kosovës, në nëntor të vitit 2022, si shenjë pakënaqësie me vendimet e Qeverisë së Kosovës në veri. Lista Serbe në mes të vitit 2022 pati konfirmuar se zyrtarë të saj të lartë, duke përfshirë edhe kryetarin e atëhershëm, Goran Rakiq, kanë qenë në listën e të dyshuarve për "rrëzimin e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës". Atëbotë pati reaguar edhe Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, duke deklaruar se për

këtë e ka njoftuar Bashkimin Evropian, që ndërmjetëson dialogun për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve. Zyrtarë të lartë të Listës Serbe zakonisht kanë mbështetur të gjitha protestat ose barrikatat e serbëve në veri të Kosovës të cilat kishin për qëllim kundërshtimin e vendimeve të Qeverisë së Kosovës ose zbatimin e tyre në terren.

Sveçla ka thënë se po punohet vazhdimisht për rritjen e efikasitetit të policisë në reagim, pasi sfida në veri janë të mëdha. "Ne asnjëherë nuk do të themi se ia kemi dalë, se nuk do të ketë sulme të reja, për aq kohe sa kemi përpara një Serbi jodemokratike, kemi një Serbi paramilitare, e qeverinë e saj fashiste".

Lista Serbe - parti që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar - ka konfirmuar se do të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë.

Autoritetet e Kosovës kanë ndërmarrë një mori veprimesh këtë vit në veri, përfshirë ndalimin e dinarit serb për kryerje të pagesave të para të gatshme dhe mbylljen e disa institucioneve paralele serbe për, siç kanë thënë, shtirje të sovranitetit. Disa prej tyre janë kritikuar nga faktori ndërkombëtar, duke u konsideruar si të njëanshme dhe i kanë kërkuar Qeverisë së Kosovës koordinim më të mirë.

Monitorimi elektronik do ta luftojë dhunën në familje

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të martën se funksionalizimi i monitorimit elektronik do ta luftojë dhunën në familje si asnjëherë më parë. Ai i ka bërë këto deklarata pas një takimi të organizuar nga Policia e Kosovës, e cila ka demonstruar se si do të funksionojnë hallkat për monitorim elektronik të kryesve të dhunës apo të dyshuarve. Shumica e viktimave të dhunës në familje janë gra. Ligji për Mbikëqyrjen Elektronike ka hyrë në fuqi në qershorin e vitit 2015, mirëpo nuk është jetësuar asnjëherë. Mbikëqyrja elektronike, që do të hyjë në fuqi menjëherë, do të vlejë për secilin individ, kanë thënë autoritetet, sapo të ketë vendim të gjykatës për

urdhër mbrojtjeje. “Ka qenë kërkesë e kamotshme që policia jonë, për të pasur parandalim më efikas, hetime më të mira dhe trajtime më gjithëpërfshirëse, të kalojë edhe në këtë fazë të hallkave për monitorim elektronik”, ka thënë Albin Kurti. Hallka do të vendoset në këmbën ose dorën e dhunuesit, ose të personit të dyshuar, ndërsa viktimat dhe autoritetet do t’i kenë gjurmuesit. Nëse viktimës i afrohet i dyshuari në zonën që ia ndalon gjykata, sinjali u shkon me automatizëm nivelit lokal dhe qendror të policisë, dhe nisin procedurat standarde për ndërhyrje. “Problemet më të mëdha i kemi për shkak se nuk respektohen urdhrat mbrojtjeje. Defekti nuk është thjesht te mungesa e hallkave



për monitorim elektronik, por te mosrespektimi i urdhrave mbrojtjeje. Meqenëse ka të tillë që do të vazhdojnë me mosrespektim të urdhrave mbrojtjeje, ne kemi bërë një hap gjigant për mbikëqyrje të të gjithë këtyre personave”, ka thënë Kurti.

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se dhuna në familje nuk është çështje private, është përgjegjësi e institucioneve, andaj pret veprime serioze nga prokuroria dhe gjykatat. Sipas Haxhiut, dënimet e buta vetëm mund t’i inkurajojnë

dhunuesit. Ministri i Brendshëm, Xhelal Sveçla, ka thënë se hallkat për mbikëqyrje do të përdoren edhe për parandalim të veprave të tjera penale, mirëpo parësor do të jetë parandalimi i përsëritjes së dhunës ndaj grave. Shefi i Policisë, Gazmend Hoxha, ka thënë se policia e ka pasur obligim zbatimin e ligjit ekzistues dhe një gjë e tillë është mundësuar pasi qeveria ka ndarë buxhet të veçantë, pa përmendur shifrën. Nga viti 2010 në Kosovë janë vlarë 58 gra. Organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në disa raste kanë fajësuar autoritetet për dështim në mbrojtjen e grave të rrezikuara nga dhuna. Në të shumtën e rasteve, autorë të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë.

Këshillit të BE-së i kërkohet ta shqyrtojë aplikimin e Kosovës për anëtarësim

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Një komision ndërparlamentar në mes të BE-së dhe Kosovës i ka bërë thirrje të martën Këshillit të BE-së t’i japë mandat Komisionit Evropian për ta shqyrtuar aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE). Komisioni, i cili vepron në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit në mes të Kosovës dhe BE-së, gjithashtu u ka kërkuar pesë vendeve anëtare të bllokut që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, ta bëjnë “sa më parë” një gjë të tillë. “Mbështesim aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE, përsërisim se shtetet e ardhshme anëtare duhet të vlerësohen në bazë të meritave individuale”, thuhet në rekomandimin e përbashkët të komisionit. Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian më 15 dhjetor të vitit 2022. Prej atëherë, presidenca e Këshillit të BE-



së është ndarë mes pesë shteteve anëtare: Çekisë, Suedisë, Spanjës, Belgjikës dhe Hungarisë. E para e ka pranuar aplikimin, por asnjë tjetër nuk e ka shqyrtuar atë. Këshilli, përkatësisht përfaqësuesit e 27 shteteve anëtare, vendosin se kur aplikacioni i dërgohet Komisionit Evropian, i cili ftohet të përgatisë një

opinion për meritat e vendit aplikues për ta marrë statusin e vendit kandidat dhe për t’i hapur negociatat e anëtarësimit. Kosova është vendi i vetëm në Ballkan që ende nuk e ka statusin e vendit kandidat. Në rekomandimet që janë miratuar përshëndetet përkushtimi i Kosovës për anëtarësim në BE, që është

synim me mbështetje të fuqishme nga qytetarët. “Shprehim bindjen e thellë se procesi i integritimit në BE sjell një fuqi domethënëse transformuese dhe konsolidim demokratik, integritet institucional dhe kohezion socio-ekonomik”, thuhet në rekomandimet. Temë kryesore e diskutimeve ishin përparimi i Kosovës në reformat e lidhura me BE-në, sundimi i ligjit dhe të drejtat e pakicave në Kosovë, dialogu me Serbinë, bashkëpunimi rajonal dhe anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Ndërkohë komisioni theksoi se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të përmbillet me njohje të ndërsjellë mes dy vendeve fqinje. Këto kërkesa u miratuan nga delegacioni i përbashkët në takimin e parë të zhvilluar në Bruksel të martën. Takimi u bashkëkryesua nga shefi i delegacionit të

Parlamentit Evropian, Davor Ivo Stier, dhe nga Mimoza Kusari, shefe e delegacionit të Kuvendit të Kosovës. Në këto rekomandime vlerësohet edhe vendimi i Kosovës për t’i hequr kufizimet për importin e mallrave nga Serbia dhe heqja e njëanshme e vizave për shtetasit e Bosnjë-Hercegovinës si kontribut për bashkëpunimin rajonal. Po ashtu, është përshëndetur edhe përparimi i Kosovës për përmbushjen e kriterëve për përfitime nga Plani i Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor. Ky komision i ka dënuar sulmet në veri të Kosovës, atë në Banjskë në vjeshtën e vitit 2023, edhe sulmin e fundit në kanalit Ibër-Lepencit, si dhe ka kërkuar që kryesisht e këtyre sulmeve sa më parë të nxirren para drejtësisë. Komisioni ka shprehur keqardhje për vazhdimin e masave që BE ka në fuqi ndaj Kosovës dhe ka bërë ftesë që ato të hiqen “menjëherë”.

Maqedonci priti në takim lamtumirës atasheun ushtarak të Republikës Federale të Gjermanisë

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur të martën në takim lamtumirës atasheun ushtarak të Republikës Federale të Gjermanisë, nënkolonel Oliver Palkowitsch. Gjatë këtij takimi ministri Maqedonci vlerësoi lart shërbimin dhe kontributin e nënkolonel Palkowitsch për realizimin e planit bilateral me Forcat e Armatosura të

Gjermanisë, mbështetjen për avancimin e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe thellimin e bashkëpunimit mes dy shteteve. “Në shenjë mirënjohjeje për angazhimin e tij të përkushtuar, ministri e nderoi nënkolonelin me një certifikatë falënderimi. Ministri Maqedonci i uroi nënkolonel Palkowitsch suksese në detyrën e tij të re

dhe shprehu mirënjohjen e institucioneve të Kosovës për kontributin e dhënë”, thuhet në njoftimin e bërë nga Ministria e Mbrojtjes. Gjithashtu, ai i uroi mirëseardhje dhe suksese në detyrën pasuesit të tij, nënkolonel Marc Abendroth, duke theksuar rëndësinë e vazhdimin të bashkëpunimit të ngushtë me Gjermaninë.



Dr. Raif Çavolli i bashkohet Lëvizjes Vetëvendosje

PRISHTINË, 10 DHJETOR - "Me një karrierë të shquar në fushën e mjekësisë kardiovaskulare, dr. Raif Çavolli sjell përvojë të pasur dhe integritet profesional në radhët e Lëvizjes Vetëvendosje! Si një kirurg i mirënjohur, ai ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm jo vetëm në shpëtimin e jetëve, por edhe në avancimin e sistemit shëndetësor në Kosovë

dhe Shqipëri, duke udhëhequr me sukses klinika dhe ekupe mjekësore", ka njoftuar LV-ja në njoftimin për medie. Sipas këtij njoftimi, dr. Çavolli është një figurë e njohur dhe e respektuar, veçanërisht për qytetarët e Pejës, duke ardhur nga një familje me traditë të gjatë në mjekësi. "Me përkushtimin dhe angazhimin e tij, ai përfaqëson modelin e

një profesionisti që punon për të mirën e përgjithshme dhe shërbimin ndaj qytetarëve. Angazhimi i dr. Çavollit në Lëvizjen Vetëvendosje! nuk do të pasurojë vetëm vizionin tonë për një shëndetësi më të fortë, por do të jetë edhe një shtysë për qeverisje të përgjegjshme, transparente dhe të orientuar drejt qytetarit", ka njoftuar LV-ja.



Aktakuzë kundër një të dyshuari për dhunë ndaj trupave të KFOR-it në Zveçan

ZVEÇAN, 10 DHJETOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër një të dyshuari lidhur me sulmin ndaj pjesëtarëve të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, në maj të vitit të kaluar në Zveçan.

Prokuroria tha në një njoftim për medie të hënën, se pas hetimeve disamujore, ngriti aktakuzë kundër të dyshuarit me inicialet D. D., për dy vepra penale, sulm ndaj personit zyrtar si dhe pjesëmarrje në turmë që kryen vepra penale dhe huliganizëm.

Sipas aktakuzës, i dyshuari "në bashkëveprim dhe koordinim" me të pandehur të tjerë të nacionalitetit serb nga Kosova e Serbia, përmes "përdorimit të dhunës, armëve e mjeteve të tjera të forta, i sulmuan dhe seriozisht i kanosën ushtarët e misionit paqeruajtës të KFOR-it, dhe pjesëtarë të Policisë së Kosovës, duke u shkakuar lëndime trupore dhe dëme materiale" gjatë protestave të 29



prillit 2023 pranë komunës së Zveçanit.

Dhuna në Zveçan shpërtheu kur serbët lokalë kundërshtuan hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në ndërtesat komunale në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok – komuna në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe, pas zgjedhjeve

të majit 2023 që ishin bojkotuar nga ta.

Prokurori tha se i ka kërkuar Gjykatës Themelore në Prishtinë të vazhdojë ta mbajë në paraburgim të dyshuarin deri në përfundim të gjykimit ndaj tij.

Policia e Kosovës e arrestoi në korrik të dyshuarin me inicialet

D. D. në rajonin e Mitrovicës së Jugut në lidhje me këto akuza. Më vonë, Policia e Kosovës në veri njoftoi se bëhej fjalë për arrestimin e Dushan Drobacit. Kosova ka fajësuar Serbinë për ngjarjet e fillimvitit 2023 në Zveçan, duke thënë se ato ishin kryer nga "grupe kriminale të afërta me presidentin e Serbisë,

Aleksandar Vuçiq".

Por, Serbia e ka mohuar një aktakuzë të tillë, duke akuzuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, se synonte t'i shtynte serbët "drejt një konflikti me NATO-n".

Dhjetëra persona janë arrestuar deri më tani për vepra të ngjashme penale në lidhje me sulmin e 29 majit 2023 në Zveçan ndaj ushtarëve të KFOR-it, por shumica e tyre u liruan për t'u mbrojtur në liri.

Gjatë përleshjeve u lënduan 93 pjesëtarë të KFOR-it, disa prej të cilëve kishin lëndime të rënda. Për shkak të dhunës në veri majin e vitit të kaluar, por edhe sulmit ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit në shtator, KFOR-i rriti praninë ushtarake në Kosovë dhe tani ka rreth 4 700 ushtarë.

KFOR-i është përgjegjësi i tretë për sigurinë e Kosovës, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit, EULEX.

FSK-ja dhe Ajova, plan të përbashkët për vitet 2025-2027



PRISHTINË, 10 DHJETOR - Në kuadër të partneritetit ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Gardës Kombëtare të Ajova-s, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, një delegacion nga FSK-ja mori pjesë në Konferencën Planifikuese për koordinimin e trajnimeve dhe aktiviteteve për vitet 2025-2027, sipas linjave të përpjekjeve: Manovrës, Mbështetjes Logjistike, Personelit, Komunikimit dhe

Kibernetikës, Mjekësisë si dhe Kanalit të Nënoficerëve dhe Zhvillimit të Liderëve. Konferenca është realizuar në Ajova të ShBA-së, bazuar në udhëzimet dhe zotimet e komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari dhe komandantit të Gardës Kombëtare të Ajova-s, gjeneralmajor Stephen Osborn, bazuar në partneritetin që ka FSK-ja me

Gardën Kombëtare të Ajova-s, delegacioni nga FSK-ja është udhëhequr nga shefi i G3/7 ShPFSK, kolonel Astrit Haliti dhe pjesëmarrje nga: G1ShP, G4ShP Rreshter Majori i FSK-se dhe KFT.


Gjatë këtij aktiviteti është rifreskuar plani i trajnimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta për vitet 2025-2026 si dhe është përfshirë edhe viti 2027, në mbështetje të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit.

Nexhmi Rexhepi zgjedhet kryetar i Gjykatës Kushtetuese

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Anëtari i Gjykatës Kushtetuese, Nexhmi Rexhepi, është zgjedhur kryetar i këtij institucioni. Lajmin e ka bërë me dije Gjykata Kushtetuese. "Në seancën administrative të mbajtur më 10 dhjetor 2024, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114

[Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kanë zgjedhur gjyqtarin, Nexhmi Rexhepi, kryetar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Mandati i Kryetarit në ardhje të Gjykatës do të filloj më 31 dhjetor 2024, pasi që Kryetarja aktuale, znj. Gresa Caka-Nimani, të

përfundojë mandatin nëntë (9) vjeçar të paraparë për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, sipas përcaktimeve të paragrafit 2 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës. Gjyqtari, z. Safet Hoxha, është zgjedhur zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese", thuhet në njoftimin për medie.



Lansohet sistemi i gjurmimit të faturave - invoice tracking

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Është lansuar sistemi i gjurmimit të faturave (invoice tracking), projekt ky i mbështetur nga USAID-i, që do t'i ndihmojë bizneset t'i pranojnë me kohë pagesat nga shteti për punët dhe shërbimet që kryejnë. Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se deri më tani kanë qenë jo të rralla rastet kur zyrtarët financiarë në organizata të ndryshme buxhetore, megjithëse kishin pranuar faturën nga operatori

ekonomik për punët ose shërbimin e kryer, e zvarrnisin pagesën e faturës kryesisht me qëllim të nxjerrjes së ndonjë ryshfeti. "Kurse fajin kryesisht e hidhnin te Ministria e Financave, duke thënë që Thesari nuk po e ekzekuton pagesën - normalisht e pavërtetë kjo. Me sistemin e ri i cili do të fillojë pilotimin javët në vijim, secili operator ekonomik që dorëzon faturë për punët ose shërbimin e kryer, do të pajiset me një QR-

code përmes të cilit mund ta përcjellë në kohë reale statusin e faturës, se në cilën fazë është, a i është miratuar për pagesë, dhe kur mund të pritët ekzekutimi i pagesës. Kështu, do të kemi më shumë transparencë, më shumë efikasitet, e më pak abuzime. Çdoherë në shërbim të qytetarëve e bizneseve, për një ekonomi të qëndrueshme e që rritet vazhdimisht. Qeveria për bizneset. Qeveria digjitale", ka shkruar Murati në "Facebook".



Ekonomia kreative në Kosovë, Kurti: Ky është sektori i nëntë më i madh për nga punësimi

EPOKA E FATON DËRMAKU

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti ka marrë pjesë të martën në hapjen e konferencës për ekonominë kreative, me titull "Perspektiva në ndryshim: krijuesit në krye të ndryshimit ekonomik", organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. "Kjo konferencë që trajton ekonominë kreative po merr vëmendje institucionale çdo ditë e më shumë. Edhe pse si term shumë i ri, ky koncept ka një kohë që vërteton me shifra shumë serioze, që talenti krijues ndikon shumë në zhvillimin dhe ngritjen e ekonomisë", tha kryeministri.

Ai ka shtuar se, sipas hulumtimeve të UNESCO-s (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë), sektori i industrive kreative në ekonominë globale në vit ka vlerë rreth 4.3 trilionë dollarësh. "Në vit gjenerohen rreth 30 milionë vende punë anembanë botës, duke punësuar grupmoshat 15 deri në 29 vjeç, më së shumti se cilido sektor tjetër. Kurse sipas UNCTAD (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim), eksporti i shërbimeve kreative ka arritur shifrën e 1.4 trilionë dollarëve në vitin 2022, duke shënuar ngritje prej 29 % nga viti 2017. Në anën



tjetër, eksporti i produkteve kreative ka arritur 713 miliardë, duke shënuar kështu ngritje prej 19 %", ka deklaruar kryeministri. Në Kosovë industria kreative kontribuon me 2.35 % në Bruto Produktin Vendor të Kosovës dhe punëson 18 920 persona, që përbën 5.2 % të të gjithë fuqisë punëtore. "Ky sektor është sektori i nëntë më i madh për nga punësimi. Në përgjithësi, kjo industri ndahet në industri kreative bazë dhe sektorë të varur ose periferikë. Industritë bazë përfshijnë marketingun, arkitekturën, tregun e artit dhe antikuarëve, artizanatin, dizajnin, modën, filmin, softuerët, interaktivë të argëtimit, muzikën, artet skenike, publikimin, softuerët dhe lojërat kompjuterike, televizionin dhe radion. Sektorët periferikë lidhen me industritë kreative bazë dhe përfshijnë industri më tradicionale si

prodhimi, shitja, pajisjet dhe instrumentet, elektronika, etj", tha ai.

Kryeministri Kurti ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës po ndjek trendet e shteteve të zhvilluara, që kanë hartuar e adaptuar politika zhvillimore për ekonominë kreative, duke u siguruar të krijohet hapësira dhe kushtet e nevojshme për zhvillim sa më të hovshëm të ekonomisë kreative. "Aktualisht është duke u hartuar strategjia për ekonominë kreative me një përfshirje të gjerë të institucioneve tona publike, natyrisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pastaj Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Planifikimit Hapësinor, Mjedisit dhe Infrastrukturës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, e pastaj me Zyrën për Planifikim Strategjik përbrenda Kryeministrisë, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës. Kjo ndërmarrje mbështetet nga UNDP (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara), nga British Council (Këshilli Britanik) dhe nga Universiteti i Lundit, me financim nga Ambasada e Luksemburgut dhe Ambasada Suedeze, e të gjitha këto i falënderojmë për partneritetin dhe bashkëpunimin e dëshmuar deri më tani", shtoi ai.

Ky sektor shihet si një shtyllë e rëndësishme e Strategjisë së Specializimit të Mençur të Kosovës, e cila po zhvillohet nga Zyra e Kryeministrisë. Në përfundim të fjalës së tij, kryeministri i falënderoi të gjithë panelistët pjesëmarrës, së bashku me moderatorët dhe uroi që, përveç ndarjes së përvojave të mira, sot të flitet e të diskutohet përmbajtësisht edhe për rrugën që duhet ta shtrijmë para nesh në raport me sfidat dhe problematikat, ashtu që të krijojmë një ambient sa më mundësues e inkurajues e inspirues për zhvillimin e mëtutjeshëm të ekonomisë sonë të përbashkët kreative. Si folës në hapje të konferencës morën pjesë dhe ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar,

Jonathan Hargreaves, ambasadori i Dukatit të Madh të Luksemburgut, Eric Dietz dhe kryesuesi i Këshillit Global për Ekonominë Kreative dhe ambasadori i kryetarit të Londrës për Ekonomi Kreative, John Newbigin.

Konferenca gjithëditore "Perspektiva në ndryshim: krijuesit në krye të ndryshimit ekonomik" synon ta zgjerojë dialogun mbi mundësitë dhe sfidat kryesore të zhvillimit të sektorit kreativ në Kosovë, si dhe të ndajë përvoja dhe ide për krijimin e një mjedisi që nxit bashkëpunimin, inovacionin dhe rritjen e qëndrueshme në industrinë kreative.

Audienca e synuar për konferencën përfshin profesionistë dhe sipërmarrës krijues nga marketingu, dizajni dhe arkitektura, artizanati, moda, letërsia, kinematografia, industria e lojërave, artet vizuale dhe skenike, publikimi, televizioni dhe radioja.

Gjithashtu, konferenca synon shoqatat e biznesit, OJQ-të, organizatat ndërkombëtare, studiuesit dhe entuziastët e rinj. Konferenca do të organizohet rreth tri tematikave kryesore: Ngritja e profilit ndërkombëtar të Kosovës; Fuqizimi i produkteve dhe shërbimeve kreative në Kosovë; dhe Roli i qeverive në zhvillimin e një ekonomie kreative të qëndrueshme.

Rritet numri i turistëve në Kosovë, prin regjioni i Pejës


PRISHTINË, 10 DHJETOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e hotelevisë për muajin tetor 2024. Në njoftim bëhet me dije se në tetor 2024 numri i vizitorëve (vëndorë dhe të huaj) në hotele ishte 57 658. Prej tyre 40 %, ishin vëndorë dhe 59.9 % ishin të jashtëm krahasuar me muajin tetor të vitit 2023 (sa ishin 55 022 vizitorë),

kishte rritje të numrit të përgjithshëm të vizitorëve në hotele për 4.6 %. Numri i net-qëndrimeve ishte 137 551, prej tyre 49.6 % nga vëndorët dhe 50.3 % nga të huajt. "Numrin më të madh të vizitorëve të brendshëm në hotele e ka regjioni i Pejës me 8 578 vizitorë dhe me 30 353 net-qëndrime", thuhet në njoftimin e ASK-së.

ASK-ja ka treguar edhe për numrin e vizitorëve të jashtëm dhe net-qëndrimet e tyre në hotele, sipas shteteve prej nga vijnë. Sa iu përket vizitorëve të huaj, krahasuar me periudhën paraprake (tetor 2023), ka rritje të vizitorëve për 13.7 %. Në total 34 488 vizitorë të huaj, nga të cilët numri më i madh është nga Shqipëria, Turqia, Gjermania, Zvicra etj.



Rreziku i rrjeteve sociale në kutitë e votimit



Të gjithë despotët e dinë se propaganda është themelore për të arritur rezultatet, por Vladimir Putini e ka një primat: ka qenë i pari që ka shfrytëzuar pushtetin e jashtëzakonshëm që kanë rrjetet sociale.

Tani që në Rumani gjykatësit kanë bllokuar zgjedhjet, me një vendim i cili është kontestuar nga disa por i bazuar në manovrat e padiskutueshme që ka bërë Moskë, në Kremlin është duke u festuar 12 vjetëshi i parë i ndërhyrjeve në zgjedhjet në vende të tjera.

Operacioni më i njohur dhe studiuar u ndërtua në vitin 2014 nga një personazh ende i panjohur në perëndim, por shumë i famshëm në Rusi për faktin që kishte akumuluar shumë pasuri me mensat, aq sa kish marrë nofken "Kuzhinieri i Putinit": Yevgeny Viktorovich Prigozhini nuk kufizohej vetëm tek kuzhina, por tërhiqte edhe fijet e një agjencie misterioze, Internet Research Agency (IRA), e cila kujdesej për interesat e Carit duke përhapur lajme të rreme.

Në vitin 2014 ai vendosi në shënjestër objektivin më të madh: Shtetet e Bashkuara. Ai krijoi 470 llogari të rreme në Facebook, të cilat postuan

80,000 postime deri në zgjedhjet e vitit 2016, duke arritur tek mbi 126 milionë njerëz. E gjitha është shkruar me saktësi në raportin prej 381 faqesh të prokurorit special Robert Mueller, të cilit iu besua hetimi nga qeveria amerikane, pas skandalit.

Çfarë kishte në postimet e Prigozhinit? Jo vetëm se duhej të votonim për Donald Trumpin: propaganda ishte gjithashtu shumë më e rafinuar. Profilet e rreme përhapnin lajme të rreme dhe u kushtoheshin ideve politike kundërshtarë: kishte nga ata në favor të zezakëve (siç është "Black Matters") dhe ata kundër emigrantëve ("Ndalni të gjithë emigrantët"), ata që mbështesnin homoseksualët ("LGBT United") dhe ato fetare ("United Muslims of America"). Kishte gjithçka dhe të kundërtën e gjithçkaje. Pse? Për të mbuluar segmentet e ndryshme të mundshme të elektoratit, dhe gjithashtu për të shfrytëzuar mekanizmin tipik të rrjeteve sociale "echo chambers", i cili u mundëson përdoruesve të shohin vetëm opinionet e veta, duke i radikalizuar ata.

Ky "polarizim" favorizoi Trumpin, edhe pse për

Muellerin nuk kishte provë që ai kishte dijeni për "masat aktive" të rusëve.

IRA, siç u zbulua më vonë, kishte zbritur në terren që dy vjet më herët. Në vitin 2012 kishte krijuar në Twitter 419 llogari për të mbështetur arsyetimin e daljes së Britanisë së Madhe nga BE dhe për të destabilizuar Bashkimin Evropian. Në shkurt të vitit 2014 kishte përhapur gënjeshtër mbi masakrat e ukrainasve në Krime për të justifikuar pushtimin. Dhe kushedi sa herë të tjera kanë vepruar pa u zbuluar.

Dihet se cili qe fundi i Prigozhinit. Pasi u bë krahu i armatosur i Moskës në Ukrainë me brigadat Wagner, bëri një përpjekje për grusht shteti dhe ekziston dyshimi që u vra. Për ironi të fatit, pasi krijoi fabrikën e lajmeve të rreme, përfundoi edhe vetë viktimë e një prej tyre. Putini ofroi një shpjegim të pagjasë të vdekjes së tij: avioni i tij nuk ishte goditur, por ishte rrëzuar prej një shpërthimit të një bombe që Kuzhinieri kishte në dorë, duke luajtur.

Vdekja e tij në 2023, megjithatë nuk e pengoi Moskën të vazhdojë të fusë hundët në zgjedhjet e vendeve të tjera. Në prag të zgjedhjeve evropiane,

këtë vit, një llogari me origjinë të gjurmuar tek një adresë ruse, @GNaktiv

shpërndau fotografinë e rreme të arrestimit të Ursula von der Leyenit, e krijuar me Inteligjencë Artificiale: gjë e cila shënonte një progres teknologjik.

Ashtu sikurse shënon evolucion fushata elektorale rumune e këtyre ditëve, që ka përdorur një rrjet social për të rinjtë, siç është TikTok dhe nuk u kufizua në krijimin e profileve fallco, por pagoi influencues të vërtetë që të mbështesnin kandidatin filorus, duke sjellë suksesin e tij, edhe pse vinte nga hiçi. Edhe ata që kritikojnë anulimin e zgjedhjeve nuk kundërshtojnë faktin që propaganda e Kremlinit ishte përcaktuese.

Nga vitet 1980 është folur shumë për ndikimin e televizionit në fushatat zgjedhore, ndoshta duke e mbivlerësuar. Tani nuk ngrihen mjaftueshëm pikëpyetje mbi ndikimin e rrjeteve sociale, ndoshta duke e nënvlerësuar. Ndoshta është rastësi që Trumpi ishte aleat me shumë të fuqishmin Elon Musk, pronar i X, i cili ka 200 milionë ndjekës? Ndikimi i vërtetë i rrjeteve sociale, në fakt, nuk qëndron

aq shumë në mbështetjen direkte dhe eksplicite, e cila edhe ajo duhet të rregullohet, se sa tek llogaritë fallco, tek lajmet e rreme, tek teoritë e komplotit, tek influencuesit e paguar nën dorë. Nuk është e lehtë të masësh se sa shumë këto veprime mund të ndryshojnë sjelljen e zgjedhësve. E sigurtë është që, qysh kur ekzistojnë rrjetet sociale përhapja e lajmeve të rreme ka arritur një nivel të paprecedentë. Dhe gënjeshtër, sipas një studimi të MIT, përhapen gjashtë herë më shpejt se sa të vërtetat, pasi krijojnë emocione më të forta dhe më të thella.

Bashkimi Evropian po lëviz: ka vendosur kufizime me "Digital Services Act" dhe në çështjen rumune ka ndërhyrë duke urdhëruar TikTokun që të ruajë të gjitha të dhënat, për të mundësuar hetime në të ardhmen.

Po a do të mjaftojë? Jemi në prag të zgjedhjeve të rëndësishme në Gjermani dhe ndoshta edhe në Francë. Që vota të jetë vërtetë e lirë, që të mund të flitet për demokraci, votuesit do të duhet të krijojnë bindjet e tyre pa kushtëzime dhe as manipulime. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Suhareka shkatërroi Llapin

SUHAREKË, 10 DHJETOR - Suhareka ka shkëlqyer në ndeshjen ndaj Llapit, pasi ka fituar me rezultat bindës 4-0. Në këtë mënyrë skuadra e drejtuar nga trajneri Qëndrim Kida u rikthehet

fitoreve në elitë. Suhareka brenda shtatë minutave në pjesën e parë shënoi tre gola. Mevlan Zeka hapi serinë e golave në minutën e 15-të duke shënuar për 1-0. Vetëm dy

minuta më vonë Rexhaj u gjend bukur afër golit dhe realizoi për 2-0. Në minutën e 22-të mbrojtësi Eneid Kodra realizoi për 3-0. Në pjesën e dytë vendasit realizuan edhe një gol

të bukur me anë të Lorik Boshnjakut për rezultatin final 4-0. Tash Suhareka ka 22 pikë dhe zë pozitën e pestë në tabelë, ndërsa Llapi është i shtati në tabelë me 17 pikë.



Federata e Motoçiklizmit e Kosovës anëtarësohet në Federatën Ndërkombëtare të Motoçiklizmit



PRISHTINË, 10 DHJETOR - Federata e Motoçiklizmit e Kosovës (FMKS) tashmë është edhe zyrtarisht pjesë e Federatës Ndërkombëtare të Motoçiklizmit (FIM).

Kryetari i kësaj federate, Nuh Lugaxhiu, ka bërë me dije në një konferencë për medie se 83 nga 121 shtete pjesëmarrëse në asamblenë e kësaj federate kanë votuar për anëtarësim të Kosovës. Ai ka thënë se ky sukses vjen pas një pune të madhe nga federata dhe institucionet e tjera sportive në Kosovë. "Federata e Motoçiklizmit e Kosovës më 6 dhjetor është pranuar ndërkombëtarisht në Federatën Ndërkombëtare të Motoçiklizmit. Ka qenë një përprjekje dhe angazhim i madh

e i gjatë ku ne kemi arritur deri në këtë pikë dhe Federata e Motoçiklizmit e Kosovës në mesin e 121 shteteve ka marrë pjesë në këtë asamble dhe është votuar me të drejtë vote. 83 vota i ka marrë Kosova dhe gjashtë kundër. Kështu që prej datës 6 dhjetor Kosova është pjesë e familjes më të madhe në botë, e familjes ndërkombëtare të motoçiklizmit", ka thënë Lugaxhiu.

Lugaxhiu ka shtuar se me këtë rast Kosovës dhe sportistëve të këtij sporti u hapen rrugë të reja për të garuar të barabartë me të gjitha shtete të tjera. "Me këtë rast Kosovës dhe gjithë sportistëve dhe sportdashësve u është hapur një derë më shumë dhe një rrugë më e rëndësishme sepse Kosova gjithmonë do të

përfaqësohet me flamurin e saj në gara ndërkombëtare dhe botërore", ka theksuar ai.

Ai ka treguar edhe nëse kishte shtete specifike që kanë tentuar ta pengojnë Kosovën drejt këtij anëtarësimi në Federatën Ndërkombëtare të Motoçiklizmit. "Jo, nuk mund të them që ka pasur iniciativa të tilla që ta pengojnë, më shumë ka qenë ideja që ta pranojnë se një shtet i vogël, Kosova, edhe gjatë diskutimit atje me presidentin e FIM-it, ka kapacitete të mëdha", ka thënë ai.

Ai ka bërë me dije se në procesin e lobimit janë mbështetur nga Komiteti Olimpik, Ministria e Sportit dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës.

Sot dy ndeshjet kthyesë në çerekfinale të Kupës

MITROVICË, 10 DHJETOR - Mesjava vazhdon me superndeshje në basketbollin e Kosovës, ku do të zhvillohen ndeshjet e kthimit dhe do të dihen skuadrat që do të depërtojnë në gjysmëfinale. Të mërkurën do të zhvillohet sfida kryesore, ku do të ndeshen Sigal Prishtina dhe Peja. "Verdhezinjtë" fituan duelin e parë 74:71, duke pasur epërsi prej tri pikësh. Prishtinasit duhet të fitojnë me katër pikë dallim për të

KUPA E KOSOVËS (ÇEREKFINALET II)

Të mërkurën takohen:

19:00 Trepça - Proton Cable Prizreni (91:73)

19:00 Sigal Prishtina - Peja (71:74)

Të enjten takohen:

19:00 Bashkimi - Bora (88:66)

19:00 Golden Eagle Ylli - Vëllaznimi (82:100)

kaluar tutje, kurse nëse fitojnë me tri pikë, ndeshja do të shkojë në vazhdimë.

Të mërkurën do të zhvillohet ndeshja tjetër ndërmjet

Trepçës dhe Proton Cable Prizrenit. Mitrovicasit fituan ndeshjen e parë me 18 pikë dhe kanë epërsi komode për të kaluar në gjysmëfinale. Epërsi nga ndeshjet e para kanë edhe Bashkimi ndaj Borës, me 22 pikë dallim, 88:66, si dhe Vëllaznimi ndaj Golden Eagle Yllit me 18 pikë epërsi, 100:82. Në kllapa janë rezultatet e ndeshjeve të para. Edhe në gjysmëfinale do të zhvillohen nga dy ndeshje, derisa finalja në shkurt të vitit të ardhshëm.



Drejtuesit e Federatës Botërore dhe Evropiane të Karatesë për tri ditë qëndruan në Kosovë

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Presidenti i Federatës Botërore dhe asaj Evropiane të Karatesë, Antonio Espinos, dhe sekretari i Përgjithshëm i Federatës Evropiane të Karatesë, Davor Cipek, qëndruan për tri ditë në Kosovë.

Espinos dhe Cipek morën pjesë në Gala Mbrëmjen e

organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) me rastin e 10-vjetorit të pranimit të KOK-ut në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar (IOC). Gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë, Espinos dhe Cipek zhvilluan takime të rregullta me krerët e Federatës së Karatesë së Kosovës, kryetarin Besart Baruti, sekretarin e

përgjithshëm Nazmi Gashi dhe anëtarin e BE-së, Gazmend Havolli. Në këto takime të rregullta temat kryesore të diskutimit ishin zhvillimi dhe avancimi i karatesë në Kosovë, trajnimet për gjyqtarët dhe trajnerët e FKK-së, si dhe kalendari ndërkombëtar i garave. Espinos dhe Cipek kaluan një

kohë shumë të këndshme në Kosovë dhe u shprehën të kënaqur nga mikpritja e KOK-ut dhe Federatës së Karatesë së Kosovës.

FKK-ja e ka falënderuar KOK-un për ftesën e udhëheqësve më të lartë të Federatës Botërore të Karatesë dhe uron KOK-un për punën e shkëlqyer. Kjo dekadë ishte e



rritjes dhe zhvillimit të sportit të Kosovës brenda familjes olimpike ndërkombëtare.

Norris paralajmëron Verstappenin: Vitin tjetër dua titullin për pilotë

BRISTOL, 10 DHJETOR - Edhe pse shpeshoi deri në fund, Lando Norris u detyrua të kënaqej me vendin e dytë për pilotë këtë sezon të Formula 1. Gjithsesi, në fund ai mundi ta festojë titullin kampion për konstruktorë me McLarenin,

një trofe i merituar, që ishte pikërisht ai që ia dhuroi makinën britanike në garën e Abu Dhabi. "Jam i lumtur që u shpallëm kampionë me McLarenin, pasi ky është një vlerësim për të gjithë skuadrën. Bëmë një punë

tëpabesueshme, duke menduar se si u rikuperuam nga vendi ku ishim në fillim. Jam krenar për të gjithë. Ka qenë një udhëtim fantastik dhe mbyllja e sezonit në këtë mënyrë është e përkryer", ka deklaruar Norris. Duke folur

për të ardhmen, piloti britanik i ka idetë e qarta: "Vitin e ardhshëm synimi do të jetë fitimi i titullit të pilotëve. Kam bërë gabime këtë vit, por kam mësuar shumë nga Max dhe nga kundërshtarët. Mezi pres të



provoj sërish vitin e ardhshëm të dueloj për fitimin e dy trofeve".

Palmer, askush në histori si sulmuesi 22-vjeçar i Chelseat

LONDËR, 10 DHJETOR - Cole Palmer vendosi një rekord të ri me penalltinë gjakftohtë kundër Tottenhamit në derbi, e cila vulosi golin e katërt të Chelseat. Por kjo është vetëm një arsye pse shumë tifozë po pyesin nëse ai tani është lojtar më i mirë në botë nga 11 metra. Palmer shënoi me një penallti spektakolare në përmbysjen në Tottenham me dy penallti dhe një asistim jozyrtar. Por këto statistika tregojnë vetëm mënyrën se si ai shkroi një pjesë të historisë së Premierë Ligës. Një goditje nga pika e bardhë për të barazuar në 2-2 ishte vetëm fillimi. Sepse sulmuesi i Anglisë ndihmoi më pas në krijimin e një goli të mrekullueshëm për Enzo Fernandezin përpara se ta vuloste rezultatin me penalltinë e dytë, e cila ishte një goditje e ëmbël "panenka" në qendër të portës. Kjo do të thotë, se vetëm 22-vjeçar, asi me 11 ndeshje me kombëtaren ka hyrë në listën e lojtarëve që shënojnë më shumë penallti radhazi pa humbur. Ai i ka shënuar 12 nga 12 penalltitë e tij në Premierë Ligë, më shumë se çdo lojtar



tjetër radhazi në historinë e kompeticionit. Palmer shkoi në derbin e së dielës me 10 penallti të shënuara, vetëm 1 më pak nga legjenda e klubit të tij të vjetër, Yaya Toure i Manchester Cityt. Palmer kishte kaluar tashmë totalin e nëntë penalltive radhazi të shënuara të Dimitar Berbatovit, plus dy lojtarë të tjerë me nga tetë: Ruben Neves dhe Raul Himenez. Por thyerja e rekordit të tij në fundjavë vetëm sa gërvishi sipërfaqen e një shfaqjeje të jashtëzakonshme

individuale. Guximi i tij në zgjedhjen e një goditjeje të dytë kaq "arrogante", nxori në pah edhe njëherë qetësinë e tij. "Kur u largova të merrja vrull, pashë orën dhe mendova se ndeshja ishte paksa e çmendur. Portieri ishte gati për t'u hedhur kështu që unë e preva topin. Thjesht po përpiqem të shënoj dhe fatmirësisht topi kaloi. Nuk e praktikoj 'panenkën' në stërvitje. Mendoj se nëse e mendon shumë, e gjuan shumë fort ose shumë butë", ka thënë Palmeri.

Futbollisti i Fiorentinës e kalon me sukses operimin

FIRENCE, 10 DHJETOR - Edoardo Bove e kishte shokuar botën e futbollit, kur pak ditë më parë u "shemb" në tokë në ndeshjen në mes të Fiorentinës dhe Interit. Futbollisti i Fiorentinës pësoi sulm në zemër e të gjithë iu frikësuan më së keqes. Por, fatmirësisht, gjërat shkuan më mirë se mendohej për Boven dhe ai tani dalëngadalë po e merr veten. Sipas medie italiane, 22-vjeçari iu nënshtrua në mëngjesin e sotëm një intervenimi kirurgjik për vendosjen e defibrilatorit nënëkërkur. Raportohet se operimi u krye me sukses në



repartin e aritmologjisë në spitalin Careggi në Firenze. Ai gjendet i shtruar në këtë spital që nga e mërkura e kaluar pas kolapsit që e pësoi në fushën e blertë më 1 dhjetor në duel me "nerazzurrët". Futbollisti pritet

të lirohet nga spitali mes së enjtes dhe të shtunës së kësaj jave. Atij i nevojitet të pushojë një kohë dhe më pas konstatimet e mjekëve do të tregojnë nëse do të jetë në gjendje apo jo t'i rikthehet me futbollit. Natyrisht, me defibrilator ai do ta ketë të vështirë të luajë më në Itali pasi Federata Italiane e ka ndaluar një gjë të tillë. Falë intervenimit të stafit mjekësor të dy klubeve, Fiorentinës e Interit, Bove mbërriti në institucionin shëndetësor me një problem që rezultoi të ishte i natyrësardiakë.

Ibra nuk e sheh vetën si trajner: Më merr shumë kohë

Zlatan Ibrahimović po e shijon punën e tij si drejtues i Milanit, por ai nuk do të ndryshojë pozitë. Legjenda suedeze është pyetur nga "Sports Illustrated" nëse do të jetë një trajner futbollit. "Jo. Unë nuk dua të jem trajner sepse është shumë punë për mua dhe më merr

shumë kohë. Duhet të mbulosh shumë fusha, të gesh ide dhe zgjidhje, të përgatitesh dhe të ndjekësh lojtarët. Ti punon ditë e natë. Një vit si trajner më duket si dhjetë vjet, kështu që nuk më tërheq", ka thënë Ibrahimović. "Shumë trajnerë kanë një filozofi dhe

një stil loje, dhe më pas lojtari individual bëhet i parëndësishëm sepse të gjithë detyrohen të adoptojnë një taktikë ose një sistem si një pjesë të vetme. Sigurisht, filozofia e një trajneri është e rëndësishme dhe përdoret për të menaxhuar ekipin. Por unë

mendoj se lojtari individual është gjëja më e rëndësishme në ekip. Sepse ai shkon në fushë dhe bën diferencën. Dhe në përgjithësi nuk mendoj se futbollit bëhet i mërzitshëm", ka deklaruar Ibra. "Përkundrazi, ndjej se ai vazhdon të rritet. Ju thjesht duhet të jeni inteligjent

dhe të mos mbylleni para zhvillimeve të reja", ka deklaruar legjenda suedeze. Zlatan Ibrahimović aktualisht është duke punuar si këshilltar i lartë në nivelet e larta drejtuese në AC Milan, duke pasur shumë liri veprimi me pronarët e tyre.

SHKURT

Conte në janar e dëshiron Ismajlin

Dy humbjet radhazi kundër Lazios, në Kupë dhe Serinë A, kanë ndikuar që trajneri i Napolit, Antonio Conte, kërkon përforsime me çdo kusht, madje këto dy humbje kanë përsheptuar edhe disa plane që Manna, drejtori sportiv i Napolit, kishte planifikuar t'i kryente në fund të këtij sezoni. Rasti më konkret është Ardian Ismajli. Napoli dhe Empoli kishin gjetur një akord paraprak që transferimi i qendërmbrojtësit kuqezi të kryhej në fund të këtij sezoni, por Contes i duhet me çdo kusht një mbrojtës i ri që në janar. Sipas "Il Mattino"-s, Ismajli ka qenë dhe mbetet opsioni i parë, kandidati i parë për ta përforsuar prapavijën. Problem në këtë pikë mbetet presidenti i Empolit, Corsi, i cili nuk lejon që Ismajli të largohet në janar pa gjetur fillimisht një mbrojtës të ri. Në këtë mënyrë, Corsi ka marrë përsipër bast të fortë pasi në fund të sezonit rrezikon të humbasë falas, pasi është e qartë që edhe Ismajli ka zgjedhur ta vijojë karrierën në Napoli ku pritet të formojë një dyshe me Rrahmanin.

NBA Cup përcakton çiftet çerekfinaliste

Sezoni 2024-2025 i NBA-së do të ndalet sot për ndeshjet e Kupës, ose NBA-Cup, që do ta luajë sezonin e tij të dytë. Tashmë janë përcaktuar tetë skuadrat e kualifikuara në fazë çerekfinale, 4 nga secila Konferencë, që do të luajnë për një vend në gjysmëfinale. Ndeshjet çerekfinale do të luhen më 10-11 dhjetor, ndërsa ndeshjet gjysmëfinale do të luhen më 14 dhjetor dhe finalja e NBA Cup do të zhvillohet në Las Vegas më 17 dhjetor. Vjet, në edicionin e parë, fitues doli skuadra e Lakersave, që këtë sezon u eliminua më herët. Ky event zhvillohet paralelisht me ndeshjet e sezonit të rregullt të NBA-së. NBA-Cup, çerekfinalistët: Milwaukee - Orlando, New York - Atlanta, Oklahoma - Dallas, Houston - Golden State.

Legjenda e Turqisë i del në mbrojtje Manajt

Emre Belozoglu është përfshirë në çështjen e krijuar për Rei Manajn, pasi ky i fundit shkaktoi faull me pasojë dëmtimin për Barish Alper Jillmaz. Ish-lojtari i Fenerbahçes, Interit dhe i përfaqësueses turke, tashmë drejtor teknik i Ankaragucu, flet për deklaratën me dy standarde të Federatës që, sipas tij, favorizon lojtarët e Galatasarayit. Po ashtu 44-vjeçari shprehet kundër sulmit të bërë prej disa tifozëve ndaj Manajt ku kërkohet largimi nga Turqia. "Pas faullit të shkaktoar kundër Barish Alper Jillmaz mendoj se është e drejtë për Federatën që të deklarojë menjëherë se është një lojtar i kombëtares. E shoh një ekzagjerim idenë që Rei Manaj duhet të largohet nga vendi", u shpreh ish-lojtari legjendar turk.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Al Va Partners” Sh.p.k Miradi e Poshtme, Fushë Kosovë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantet e prodhimit të betonit linja 1 dhe linja 2 në Miradi e Epërme, Fushë Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.02.2025 në ora 10:00 në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët “Vëllezërit Frashëri”, në Fushë Kosovë do të organizohet debat publik nga Kompania “Al Va Partners” Sh.p.k Miradi e Poshtme, Fushë Kosovë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën elektronike

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Al Va Partners” Sh.p.k Miradi e Poshtme, Fushë Kosovë për impiantet e prodhimit të betonit linja 1 dhe linja 2 në Miradi e Epërme, Fushë Kosovë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin ynm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Rahoveci Solar Energy Park” Sh.p.k Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun solar Rahoveci 1B me kapacitet 9.380 MW në Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.02.2025 në ora 10:30 në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët “Isa Boletini”, në Rahovec do të organizohet debat publik nga Kompania “Rahoveci Solar Energy Park” Sh.p.k Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën elektronike

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Rahoveci Solar Energy Park” Sh.p.k Prishtinë për parkun solar Rahoveci 1B me kapacitet 9.380 MW në Rahovec.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin ynm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Rahoveci Solar Energy Park” Sh.p.k Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun solar Rahoveci 1A me kapacitet 9.455 MW në Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.02.2025 në ora 10:00 në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët “Isa Boletini”, në Rahovec do të organizohet debat publik nga Kompania “Rahoveci Solar Energy Park” Sh.p.k Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën elektronike

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Rahoveci Solar Energy Park” Sh.p.k Prishtinë për parkun solar Rahoveci 1A me kapacitet 9.455 MW në Rahovec.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin ynm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mustafë Beka nga Gjakova shpall të qendër prapa teatrit Kombëtar, me pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një “Nexhmedin Nixha” Gjakovë dega dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Tekstil. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Idol Lleshi nga Gjakova shpall të qendër prapa teatrit Kombëtar, me pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “ Hajdar Dushi” Gjakovë. - Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Endrit Dhomi nga Gjakova shpall të qendër prapa teatrit Kombëtar, me pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë. - Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër qershori deri me 1 qira , ne lagjen Dardania afër gusht (dy muaj), çmimi sipas Postës Kryesore (posta e Madhe) marrëveshjes. Për informata në tel. Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata 044/171-328. lajmërohuni në tel: 044/558-894
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qira , ne lagjen Dardania afër gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata 044/171-328. lajmërohuni në tel: 044/558-894
- Lëshoj banesën e re me qera në Prishtinë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskoo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar
 Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom
 Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 10.12.2024

Referenca: AAPSK – 015/2024

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:


Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	VW Golf III viti i prodhimit 1994, dizel ngjyrë vishnje, me targa vendore-Rishpallje	1 copë	900.00€		
2	Suzuki FJ JIMNY viti i prodhimit 2001, benzin, shumë ngjyrësh, me targa vendore-Rishpallje	1 copë	3,780.00€		
3	VW Jetta, ngjyrë e gjelbër metalike viti i prodhimit 1986 benzin- për skrap	1 copë për skrap	156,06€		
4	VW Cady, ngjyrë e bardhë viti i prodhimit 1999, dizel- për pjesë	1 copë për pjesë	500.00€		
5	Golf II, ngjyrë e zezë, viti i prodhimit 1989 dizel- për skrap	1 copë për skrap	212.98€		
6	VW Caddy, ngjyrë e bardhë viti i prodhimit 2010, dizel- me targa të huaja	1 copë	3,000.00€		
7	Rimorkio-Punim Dore Metalike-për pjesë	1 copë për pjesë	200.00€		
8	Audi 8Z A2 1,4, viti i prodhimit 2000,benzin- me targa vendore	1 copë	1,800.00€		
9	Mercedes-C220 CDI,dizel,viti i prodhimit 2003--për skrap	1 copë-për skrap	340.40€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri më 17.12.2024 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 17.12.2024, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë, kurse mallin me numer rendor 4 mund ta shikojnë me datë: 16.12.2024, prej orës 10:00-11:00 në Qendrën Korrektuese në Smrekovicë.

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aaprk.gov.net> apo <https://md.rks.gov.net/>.

Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË





TRADITË QË NGA

1992

